



VENDIM
Nr.66 Datë 13.09.2010

PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS TË
FURNIZIMIT PUBLIK ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA OSSH SH.A PËR KONSUMATORËT TARIFORË

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20, 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.03.2009, Vendimit nr.80, datë 26.06.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 13.09.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e OSSH sh.a për përcaktimin e tarifës të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike nga OSSH sh.a për konsumatorët tariforë, për vitin 2011 dhe relacionin e grupit të punës,

Vendosi :

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës të furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike nga OSSH sh.a. për konsumatorët tariforë për vitin 2011.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSSH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.sh.a.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar NEPRAVISHTA